



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosova**  
*Qeveria - Vlada - Government*  
*Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister*  
*Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics*

## **Seria 5: Statistikat Sociale**

# **Rezultatet e Anketës mbi të Ardhurat dhe Kushtet e Jetesës 2022**







**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*  
*Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister*  
*Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics*

## **Seria 5: Statistikat Sociale**

# **Rezultatet e Anketës mbi të Ardhurat dhe Kushtet e Jetesës 2022**



Botues: Agjencioni i Statistikës së Kosovës (ASK)  
Data e botimit: Dhjetor, 2023  
© Agjencioni i Statistikës së Kosovës  
Riprodhimi autorizohet nëse tregohet burimi.  
Informata të shumta janë në dispozicion në internet,  
ku mund të qaseni përmes ueb-faqes së ASK-së

## Parathënie

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), përkatësisht Departamenti i Statistikave Sociale (DSS) ka përgatitur publikimin e radhës Rezultatet e Anketës mbi të ardhurat dhe kushtet e jetesës (AAKJ) 2020. Për herë të parë AAKJ u zhvillua në vitin 2018 mbështetur nga Banka Botërore dhe ka vazhduar si anketë e rregullt vjetore, e njohur si EU-SILC.

Qëllimi i publikimit të rezultateve të Anketës mbi të ardhurat dhe kushtet e jetesës (AAKJ) është që të ofrojmë të dhëna statistikore për kushtet e jetesës të ekonomive familjare në Kosovë dhe për çështjet tjera të ngjashme që kanë të bëjnë me standardin jetësor.

Në këtë publikim janë paraqitur rezultatet në formë përmbledhëse për kushtet e jetesës së ekonomive familjare në vitin 2022.

Përmes këtij publikimi është synuar zbutja e mungesës së informacioneve në fushën e standardit jetësor të ekonomive familjare në Kosovë. Besojmë se ky publikim do të shërbejë si një bazë e dobishme referuese për të gjithë shfrytëzuesit e të dhënave statistikore.

I

Publikimin përgatitën:

Ismajl Sahiti – u.d. Drejtor i Departamentit të Statistikave Sociale,  
Naime Rexhepi – Udhëheqëse e Divizionit të Statistikave Sociale  
Hydai Morina – Zyrtar i statistikave të Standardit Jetësor,  
Fjolla Shala – Zyrtare e statistikave të TIK në ekonomi familjare,  
Bekim Canolli – Udhëheqës i Divizionit të Metodologjisë,  
Servete Muriqi – Zyrtare e lartë për metodologji.

Dhjetor, 2023

U.d i Kryeshefit Ekzekutiv i ASK-së,  
Avni Kastrati

## Lista e shkurtesave dhe simboleve

---

- SILC - Anketa mbi të ardhurat dhe kushtet e jetesës
- ASK - Agjencia e Statistikave të Kosovës
- BE - Bashkimi Evropian
- DSS - Departamenti i Statistikave Sociale
- DMTI - Departamenti i metodologjisë dhe teknologjisë informative

Më pak se gjysma e njësisë së përdorur

- % - Përqindje

## Përmbajtja

Objektivi dhe shtrirja e anketës.....	9
Metodologjia.....	10
Të dhënat bazë nga Anketa e të Ardhurave dhe Kushteve të Jetesës (AAKJ) në vitin 2022.....	11
Numri i dhomave në ekonomitë familjare në Kosovë.....	11
Fig. 1: Mesatarja e numrit të dhomave në ekonomitë familjare në Kosovë .....	11
Numri i dhomave për anëtar në ekonomitë të familjare në Kosovë.....	12
Fig. 2: Mesatarja e numrit të dhomave për anëtar në ekonomitë familjare në Kosovë.....	12
Statusi i pronësisë së shtëpive dhe banesave.....	13
Fig. 3: Shkalla e pronësisë së shtëpive dhe banesave .....	13
Ekonomitë familjare që mund të përballojnë një javë pushimi larg shtëpisë .....	14
Fig. 4: Përballueshmëria e ekonomive familjare për një javë pushimi larg shtëpisë .....	14
Ekonomitë familjare që mund të përballojnë shujtën me mish, pule dhe peshk çdo të dytën ditë .....	15
Fig. 5: Përballueshmëria e ekonomive familjare e shujtës me mish, pule dhe peshk çdo.....	15
të dytën ditë .....	15
Ekonomitë familjare të cilat mund të përballojnë një shpenzim të papritur prej 100€.....	16
Fig. 6: Përballueshmëria e ekonomive familjare e një shpenzimi të papritur prej 100€.....	16
Ekonomitë familjare të cilat mund të përballojnë pajisjet apo mjetet afatgjata .....	17
Fig. 7: Përballueshmëria e ekonomive familjare për pajisjet apo mjetet afatgjata.....	17
Përballueshmëria e ekonomive familjare për të mbajtur shtëpinë të ngrohtë në mënyrë adekuate .....	18
Fig. 8: Përballueshmëria e ekonomive familjare për të mbajtur shtëpinë të ngrohtë .....	18
në mënyrë adekuate.....	18
Barra financiare për kthimin e kredive për ekonomitë familjare në Kosovë .....	19
Fig. 9: Barra financiare për kthimin e kredive për ekonomitë familjare në Kosovë .....	19
Ekonomitë familjare të cilat kanë vështirësi në kryerjen e pagesave të nevojshme .....	20
Gjendja shëndetësore e individëve në Kosovë.....	21
Fig. 11: Gjendja e përgjithshme shëndetësore te individët në Kosovë .....	21
Lloji i ndërtesës së banimit.....	23
Fig. 13: Lloji i ndërtesës së banimit të individëve në ekonomitë familjare .....	23
Konkluzione.....	24





## Objektivi dhe shtrirja e anketës

**Anketa e të Ardhurave dhe Kushteve të Jetesës (AAKJ) është në përputhje të plotë me metodologjinë e Eurostat-it dhe metodologjinë që përdorin të gjitha vendet e tjera anëtare të Bashkimit Evropian.**

Anketa e të Ardhurave dhe Kushteve të Jetesës (AAKJ) është një instrument për mbledhjen e mikro të dhënave në kohë dhe të krahasueshme mbi të ardhurat, varfërinë, përjashtimin social dhe kushtet e jetesës. Metodologjia e përdorur për hartimin e pyetësorëve bazohet në metodologjinë e Eurostat-it që përdoret nga të gjithë vendet e BE-së.

Grumbullimi i të dhënave në teren është bërë përmes metodës CAPI/tabletit (asistencë kompjuterike për grumbullimin e të dhënave) përmes aplikacionit Survey Solutions.

Deri në vitin 2017 sigurimi i informacionit për treguesit kryesorë të nivelit të jetesës, mirëqenies, varfërisë dhe treguesve të tjerë është siguruar nëpërmjet Anketës së Buxhetit të Ekonomive Familjare (ABEF).

## Metodologjia

Nëpërmjet Anketës së të ardhurave dhe kushteve të jetesës (AAKJ) është synuar që të bëhet matja e mirëqenies dhe treguesve të kushteve të jetesës .

Nisur nga ndryshimet metodologjike të përdorura në këto dy anketa pritet që edhe informacioni nga Anketa e të Ardhurave dhe Kushteve të Jetesës (AAKJ) të jetë i ndryshëm, krahasuar me të dhënat e ofruara Anketa e Buxhetit të ekonomive familjare (ABEF).

**Mbulimi:** Anketa e të Ardhurave dhe Kushteve të Jetesës (AAKJ) mbulon të gjitha Ekonomitë Familjare në territorin e Republikës së Kosovës pavarësisht nga madhësia e tyre ose karakteristikat socio-ekonomike.

**Nuk marrin pjesë në anketa:** Individët që jetojnë në banesa kolektive të të gjitha llojeve (konviktet, shtëpitë e të moshuarve, spitalet, burgjet, qendrat e rehabilitimit, kampet etj.).

**Ekonomia Familjare:** Ekonomia familjare përfshinë të gjithë personat që jetojnë në një shtëpi apo banesë të përbashkët dhe që kanë të përbashkëta mjetet kryesore të jetesës.

**Madhësia e mostrës:** Anketa e të Ardhurave dhe Kushteve të Jetesës (AAKJ) në vitin 2022 përfshin një mostër prej 2.699 ekonomi familjare.

Në vitin 2022 janë përsëritur 75% e ekonomive familjare nga viti 2021 dhe 25% të ekonomive familjare janë bashkangjitur në vitin 2022, që në total japin 2.699 ekonomi familjare, në 75% te ekonomive familjare të përsëritura nga vitin 2019, janë ri-anketuara vetëm familjet të cilat kanë pranuar të intervistohen, duke ju përmbajtur metodologjisë.

Metodologjia e EU-SILC është si me poshtë e cila ndahet në 4 grupe nga 25%, ku për çdo vite, një grup ndahet ndërsa 3 grupe të tjera vazhdojnë ri-anketimin vitin tjetër.

2019	2	3	4	1			
	2020	3	4	1	2		
		2021	4	1	2	3	
			2022	1	2	3	4


## Të dhënat bazë nga Anketa e të Ardhurave dhe Kushteve të Jetesës (AAKJ) në vitin 2022

Shënim: Anketa e të Ardhurave dhe Kushteve të Jetesës zhvillohet sipas praktikës së përsëritur të ri-anketimit dhe për shkak të aplikimit të metodës së tillë shumë shtete kanë praktikuar që të mos publikojnë të dhëna deri në përfundimin e ciklit katërvjeçar me qëllim që të shikohen proceset dhe vlerësohen indikatorët.

### Numri i dhomave në ekonomitë familjare në Kosovë

Mesatarja e numrit të dhomave për një ekonomi familjare është pak më e lartë në vendbanimet rurale me 4.58 dhoma krahasuar me ato urbane që ishte 4.24 dhoma për një ekonomi familjare. Ndërsa mesatarja e numrit të dhomave për një ekonomi familjare në nivel të Kosovës ishte 4.45 dhoma.


**Fig. 1: Mesatarja e numrit të dhomave në ekonomitë familjare në Kosovë**



## Numri i dhomave për anëtar në ekonomitë të familjare në Kosovë

Mesatarja e numrit të dhomave për anëtar në një ekonomi familjare është pak më e lartë se në vendbanimet urbane me 1.45 dhoma, krahasuar me ato rurale që kishin 1.52 dhoma për anëtar një ekonomi familjare. Ndërsa mesatarja e numrit të dhomave për një ekonomi familjare në nivel të Kosovës ishte 1.49 dhoma.


**Fig. 2: Mesatarja e numrit të dhomave për anëtar në ekonomitë familjare në Kosovë**



## Statusi i pronësisë së shtëpive dhe banesave

Sa i përket shkallës së pronësisë së shtëpive dhe banesave, 95.1% e ekonomive familjare kishin në pronësi me akt ligjor shtëpitë/banesat, 1.4% e ekonomive familjare ishin qiramarrës ose nën qiramarrës që paguajnë qira me normën e tregut , për 0.1% të ekonomive familjare akomodimi është marr me qira me një çmim më të ulët të tregut , ndërsa për 3.4% të ekonomive familjare akomodimi ofrohet falas.


**Fig. 3: Shkalla e pronësisë së shtëpive dhe banesave**



## Ekonomitë familjare që mund të përballojnë një javë pushimi larg shtëpisë

Rreth 45.7% e ekonomive familjare në Kosovë mund të përballojnë shpenzimet e një jave pushimi larg shtëpisë, duke përfshirë qëndrimin në një shtëpi tjetër (shtëpi vikendi), apartament ose tek miqtë ose të afërmit, përderisa 54.3% e ekonomive familjare nuk mund ta përballojë këtë shpenzim.


**Fig. 4: Përballueshmëria e ekonomive familjare për një javë pushimi larg shtëpisë**



### Ekonomitë familjare që mund të përballojnë shujtën me mish, pule dhe peshk çdo të dytën ditë

Rreth 50.8% e ekonomive familjare në Kosovë mund të përballojnë shujtën me mish, pule dhe peshk çdo të dytën ditë, përderisa 49.2% e ekonomive familjare nuk mund të përballojnë këtë shpenzim.


**Fig. 5: Përballueshmëria e ekonomive familjare e shujtës me mish, pule dhe peshk çdo të dytën ditë**



## Ekonomitë familjare të cilat mund të përballojnë një shpenzim te papritur prej 100€

Rreth 56.6% e ekonomive familjare në Kosovë mund të përballojnë një shpenzim të papritur prej 100 € dhe të paguaj prej burimeve vetanake, ndërsa 43.4% e ekonomive familjare nuk mund të përballojnë një shpenzim të papritur prej 100 €.

**Fig. 6: Përballueshmëria e ekonomive familjare e një shpenzimi të papritur prej 100€**






## Ekonomitë familjare të cilat mund të përballojnë pajisjet apo mjetet afatgjata

Rreth 96.0% e ekonomive familjare në Kosovë janë të pajisur me makinë transporti dhe 54.9% e ekonomive familjare janë të pajisur me kompjuter.


**Fig. 7: Përballueshmëria e ekonomive familjare për pajisjet apo mjetet afatgjata**



## Përballueshmëria e ekonomive familjare për të mbajtur shtëpinë të ngrohtë në mënyrë adekuate

Rreth 73.4% e ekonomive familjare ishin në gjendje të përballojnë mbajten e shtëpisë të ngrohtë në mënyrë adekuate, përderisa për 26.6% të ekonomive familjare ishte e pa përballueshme mbajtja e shtëpisë ngrohtë në mënyrë adekuate.


**Fig. 8: Përballueshmëria e ekonomive familjare për të mbajtur shtëpinë të ngrohtë në mënyrë adekuate**



## Barra financiare për kthimin e kredive për ekonomitë familjare në Kosovë

Për rreth 48.8% të ekonomive familjare ishte barrë e rëndë financiare pagesa e borxheve për kartë kredit, blerje të madhe ose kredi të tjera (duke përjashtuar pagesat peng ose kredi të tjera lidhur me blerjen e shtëpisë apo banesës), për 39.9% të ekonomive familjare ishte deri diku barrë financiare, përderisa për 11.3% të ekonomive familjare nuk ishte barrë financiare.


**Fig. 9: Barra financiare për kthimin e kredive për ekonomitë familjare në Kosovë**



## Ekonomitë familjare të cilat kanë vështirësi në kryerjen e pagesave të nevojshme

Rreth 8.1% e ekonomive familjare kishin vështirësi të mëdha në kryerjen e pagesave të nevojshme marrë parasysh të ardhurat totale dhe gjendjen për të kryer pagesat e nevojshme të zakonshme, 20.1% e ekonomive familjare e përballonin me vështirësi, 43.6% me disa vështirësi, përderisa 12.9% e ekonomive familjare e përballonin mjaft lehtë, 11.7% lehtë, dhe 3.6% shumë lehtë.


**Fig. 10: Vështirësitë e ekonomive familjare në kryerjen e pagesave të nevojshme**



## Gjendja shëndetësore e individëve në Kosovë

Rreth 81.4% e individëve në ekonomitë familjare kanë deklaruar se gëzojnë shëndet shumë të mirë, 11.9% e individëve në ekonomitë familjare janë deklaruar me shëndet jo të keq, ndërsa 6.7% e individëve në ekonomitë familjare kanë deklaruar se kanë shëndet shumë të dobët.


**Fig. 11: Gjendja e përgjithshme shëndetësore te individët në Kosovë**



## Përballueshmeria e ndërrimit të mobilie

Rreth 46.2% e individëve në ekonomitë familjare kanë deklaruar se mund të zëvendësojnë mobilje të vjetra me ato të reja, 29.0% e individëve në ekonomitë familjare janë deklaruar se nuk mund të zëvendësojnë mobilje të vjetra me ato të, ndërsa 24.8% e individëve në ekonomitë familjare kanë deklaruar se për arsye tjetër nuk do të zëvendësojnë mobilje të vjetra me ato të reja.


**Fig. 12: Ekonomitë familjare të cilat mund të zëvendësojnë mobileje të vjetra me ato të reja**



## Lloji i ndërtesës së banimit

Rreth 93.5% e individëve në ekonomitë familjare kanë deklaruar se jetojnë në shtëpi të veçuar, të ndarë në vete, 1.6% e individëve në ekonomitë familjare janë deklaruar se jetojnë në shtëpi gjysmë të ndarë dy banesa, 1.8% e individëve në ekonomitë familjare kanë deklaruar se jetojnë në ndërtesa me më pak se 10 banesa, ndërsa 3.1% e individëve në ekonomitë familjare janë deklaruar se jetojnë në ndërtesa me më shumë se 10 banesa.

**Fig. 13: Lloji i ndërtesës së banimit të individëve në ekonomitë familjare**



## Konkluzione

Agjencia e Statistikave të Kosovës respektivisht DSS përmes Anketës mbi të ardhurat dhe kushtet e jetesës (SILC) është munduar të plotësoj vakumin në mungesë të informacioneve në fushën e standardit jetësor të ekonomive familjare.

Qëllimi kryesor i këtij raporti është vlerësimi i kushteve të jetesës në nivel vendi për vitin 2022.

Bazuar në rezultatet e AAKJ 2022 rezultojnë se:

Mesatarja e numrit të dhomave për një ekonomi familjare në Kosovë ishte 4.45 dhoma, ku 4.24 dhoma ishte në zonat urbane, ndërsa 4.58 dhoma në zonat rurale. (Fig. 1)

Mesatarja e numrit të dhomave për anëtar në ekonomitë familjare në Kosovë ishte 1.49 dhoma, d.m.th më shumë se 1 dhomë për person, ku 1.45 ishte në zonat urbane, ndërsa 1.52 në zonat rurale. (Fig. 2)

95.1% e ekonomive familjare kishin në pronësi me akt ligjor shtëpitë/banesat, 1.4% e ekonomive familjare ishin qiramarrës ose nën qiramarrës që paguajnë qira me normën e tregut, për 0.1% të ekonomive familjare akomodimi është marr me qira me një çmim më të ulët të tregut, ndërsa për 3.4% të ekonomive familjare akomodimi ofrohet falas. (Fig. 3)

45.7% e ekonomive familjare mund të përballojnë shpenzimet e një jave pushimi larg shtëpisë, duke përfshirë qëndrimin në një shtëpi tjetër (shtëpi vikendi), apartament ose tek miqtë ose të afërmit, ndërsa 54.3% e ekonomive familjare nuk mund ta përballojë këtë shpenzim. (Fig. 4)

50.8% e ekonomive familjare mund të përballojnë shujtën me mish, pule dhe peshk çdo të dytën ditë, ndërsa 49.2% e ekonomive familjare nuk mund të përballojnë këtë shpenzim. (Fig. 5)

56.6% e ekonomive familjare mund të përballojnë një shpenzim të papritur prej 100 € dhe të paguaj prej burimeve vetanake, ndërsa 43.4% e ekonomive familjare nuk mund të përballojnë një shpenzim të papritur prej 100 €. (Fig. 6)

96.0% e ekonomive familjare janë të pajisur me makinë transporti dhe 54.9% e ekonomive familjare janë të pajisur me kompjuter. (Fig. 7)

73.4% e ekonomive familjare ishin në gjendje të përballojnë mbajtjen e shtëpisë të ngrohtë në mënyrë adekuate, përderisa për 26.6% të ekonomive familjare ishte e pa përballueshme mbajtja e shtëpisë ngrohtë në mënyrë adekuate. (Fig. 8)

Për 48.8% të ekonomive familjare ishte barrë e rëndë financiare pagesa e borxheve për kartë kredit, blerje të madhe ose kredi të tjera (duke përjashtuar pagesat peng ose kredi të tjera lidhur me blerjen e shtëpisë apo banesës), për 39.9% të ekonomive familjare ishte deri diku barrë financiare, përderisa për 11.3% të ekonomive familjare nuk ishte barrë financiare. (Fig. 9)

8.1% e ekonomive familjare kishin vështirësi të mëdha në kryerjen e pagesave të nevojshme marrë parasysh të ardhurat totale dhe gjendjen për të kryer pagesat e nevojshme të zakonshme, 20.1% e ekonomive familjare e përballonin me vështirësi, 43.6% me disa vështirësi, përderisa 12.9% e ekonomive familjare e përballonin mjaft lehtë, 11.7% lehtë, dhe 3.6% shumë lehtë. (Fig. 10)

81.4% e individëve në ekonomitë familjare në Kosovë kanë deklaruar se gëzojnë shëndet shumë të mire, 11.9% e individëve në ekonomitë familjare me shëndet jo të keq, ndërsa 6.7% e individëve në ekonomitë familjare me shëndet shumë të dobët. (Fig. 11)



Rreth 46.2% e individëve në ekonomitë familjare kanë deklaruar se mund të zëvendësojnë mobilje të vjetra me ato të reja, 29.0% e individëve në ekonomitë familjare janë deklaruar se nuk mund të zëvendësojnë mobilje të vjetra me ato të reja, ndërsa 24.8% e individëve në ekonomitë familjare kanë deklaruar se për arsye tjetër nuk do të zëvendësojnë mobilje të vjetra me ato të reja. (Fig. 12)

Rreth 93.5% e individëve në ekonomitë familjare kanë deklaruar se jetojnë në shtëpi të veçuar, e ndarë ne vete, 1.6% e individëve në ekonomitë familjare janë deklaruar se jetojnë në shtëpi gjysmë të ndarë dy banesa, 1.8% e individëve në ekonomitë familjare kanë deklaruar se jetojnë në ndërtesa me më pak se 10 banesa, ndërsa 3.1% e individëve në ekonomitë familjare janë deklaruar se jetojnë në ndërtesa me më shumë se 10 banesa. (Fig. 13)

## Agjencia e Statistikave te Kosovës: Përshkrim i shkurtër

---

**Agjencia e statistikave të Kosovës** është institucion profesional i cili merret me grumbullimin, përpunimin dhe publikimin e të dhënave zyrtare të statistikave. Si i tillë vepron që nga viti 1948 i cili ka kaluar nëpër disa faza historike, i strukturuar sipas rregullimit shtetëror të asaj kohe.

Më 2 Gusht 1999, Agjencioni ka rifilluar punën e vet profesionale (pas 9 viteve të ndërprerjes të të gjitha shërbimeve statistikore në dëm të interesit të Kosovës), si institucion i pavarur në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike. Që nga data 12.12.2011 ky Agjencion vepron në kuadër të Kryeministrisë së Kosovës. Agjencioni financohet nga Buxheti i Republikës së Kosovës por edhe nga donatorët për projekte të veçanta dhe për ndihmë teknike profesionale.

**Agjencia e Statistikave të Kosovës** vepron sipas Ligjit Nr. 04/L-036 i cili ka hyrë në fuqi me 12.12.2011 si dhe Ndryshim Plotësimin e Ligjit Nr. 06/L-058 i cili ka hyrë në fuqi me 17.01.2019. Programi i Statistikave Zyrtare, 2018/2022 është në implementim për zhvillimin e sistemit statistikor në korrelacion me Statistikat e Bashkësisë Evropiane (EUROSTAT-it).

**Agjencia e statistikave të Kosovës** ka këtë strukturë organizative: **Departamentet prodhuese;** *Departamenti i statistikave ekonomike dhe llogarive kombëtare, Departamenti i statistikave të bujqësisë dhe mjedisit, dhe Departamenti i statistikave sociale.* **Departamentet mbështetëse;** *Departamenti i metodologjisë dhe teknologjisë informative, Departamenti për politikë, planifikim, koordinim dhe komunikim, Departamentii i Regjistrimit dhe Anketimit si dhe Departamenti i administratës.* **Ne kuadër të Agjencionit veprojnë edhe; Zyrat Rajonale;** Gjakovë, Gjiilan, Mitrovicë, Pejë, Prizren, Prishtinë, dhe Ferizaj.

Të punësuar janë gjithsej 156 punëtorë, prej tyre, 115 në seli të Agjencionit, gjersa në Zyrat Rajonale, 41 Agjencioni ka këtë strukturë kualifikuese, 123 me shkollim universitar, 15 me shkollim të lartë, ndërsa 18 me shkollim të mesëm.

Kemi bashkëpunim profesional dhe teknik me të gjitha Ministrinë e Qeverisë së Kosovës, sidomos me Ministrin e Ekonomisë dhe Financave, Bankën Qendrore të Kosovës, me institucionet ndërkombëtare, EUROSTAT-in, Fondin Monetar Ndërkombëtare, Bankën Botërore, SIDA e Suedisë, DFID, UNFPA, UNDP, UNICEF, dhe me statistikave të shteteve në rajon.

**Agjencia e Statistikave të Kosovës** mbulon gati krejtësisht territorin e Republikës së Kosovës, duke u organizuar në strukturimin e qarqeve statistikore dhe njësisve raportuese si njësi bazë dhe të vetme në shkallë vendi nga të cilat merr informatat e dorës së parë. Te gjitha anketat e zhvilluara në terren përdorin shtrirjen e mostrës në këto qarqe statistikore por edhe metodologjinë sipas rekomandimeve ndërkombëtare. Gjatë grumbullimit të të dhënave statistikore dhe raporteve nga njësitë raportuese angazhohen; profesionistë, teknikë, administratorë, civilë të zyrave të vendit, regjistruar terreni nga Zyrat Rajonale etj.

Në vitin 2011 është realizuar me sukses projekti i Regjistrimit të Popullsisë Ekonomike Familjar dhe Banesave, ndërsa në vitin 2014 është realizuar po ashtu me sukses Regjistrimi i Bujqësisë. Rezultatet e fituara nga këto regjistrime do të kenë një rol të rëndësishëm për hartimin e Politikave zhvillimore.

**Misioni i Agjencionit;** të përmbush nevojat e shfrytëzuesve me të dhëna statistikore kualitative, objektive, në kohë dhe hapësirë në mënyrë që shfrytëzuesit të kenë bazë të besueshme që të bëjnë analiza të rregullta në interes të planifikimit dhe zhvillimit gjatë hartimit të projekteve në shkallë vendbanimi, komune dhe vendi. Të përkrah institucionet qeveritare, institutet, shkencën, akademinë, bizneset si dhe hulumtuesit e pavarur etj. në mënyrë që t'u sigurojë informata të duhura për vendim-marrësit si dhe përdoruesit tjerë në Kosovë.

**Adresa:**

**AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS**

Rr. "Zenel Salihu", nr. 4, 10000 Prishtinë

**Telefoni:**

+383 (0) 38 200 31 129

**Kryeshefi Ekzekutiv:**

+383 (0) 38 200 31 112

**Fax:**

+383 (0) 38 235 033

**E-mail:**

infoask@rks-gov.net

**Ueb-faqe:**

<http://ask.rks-gov.net>